



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË
PROFESIONALE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

RAPORT VJETOR I VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË
ETIKËS DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE
PËR VITIN 2023

DREJTUAR : MBLEDHJES PLENARE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE.....	3
II. RAPORTIM I VJEÇAR PËR SISTEIMIN E VLERESIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARËVE	4
A. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E AKTEVE PLOTËSUESSES TË SKEMËS SË VLERËSIMIT	4
B. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT LIDHUR ME PROCEDURAT E VLERESIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARËVE TË FILLUARA GJATË VITIT 2023	5
B.I Fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradim) për periudhën e vlerësimit 2013-2016	6
B.II Fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar për vitin e fundit kalendarik	9
B.III Fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2020-2022.....	10
B.IV Fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarët e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.....	11
B.V Miratimi i listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dry vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele.....	12
C. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT LIDHUR ME PROCEDURAT E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARËVE TË PËRFUNDUARA GJATË VITIT 2023	13
C.I Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (Gradim) për periudhën e vlerësimit 2013-2016.....	13
C.II Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar për vitin e fundit kalendarik.....	15
C.III Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019.....	16
C.IV Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2020-2022.....	18
C.V Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë	18
C.VI Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarët e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.....	19
III. VEPRIMTARI TË TJERA TË KOMISIONIT	20
A. TRAJTIMI I KËRKESAVE TË GJYQTARËVE DHE HARTIMIN E AKTEVE ADMINISTRATIVE INDIVIDUALE.....	20
B. VEPRIMTARITË JASHTË FUNKSIONIT	20
C. BASHKËPUNIMI ME SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS	20
D. ÇËSHTJE TË TJERA.....	21
IV. REKOMANDIME.....	22

Raporti vjetor i punës së KVEVP hartohet në bazë të parashikimeve të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 62, pika 16 të të cilit parashikohet se: *“16. Brenda muajit janar të çdo viti kalendarik, secili komision i përhershëm paraqet në mbledhjen plenare të Këshillit raportin vjetor të veprimtarisë me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit”*.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (në vijim Komisioni) është një ndër katër Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me vendimin nr.601, datë 23.12.2021, të ndryshuar me vendimin nr.79, datë 02.03.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë zgjedhur anëtarë të përhershëm të Komisionit znj.Brikena Ukperaj, znj.Irena Plaku, znj.Yllka Rupa dhe anëtarë zëvendësues znj.Fatmira Luli dhe z.Ridvan Hado. Ky Komisionin ushtron funksionet sipas përcaktimeve të nenit 62, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, i ndryshuar. Me vendimin nr. 742, datë 26.12.2023, për shkak të përfundimit të mandatit të znj.Brikena Ukperaj, është zgjedhur anëtare e KVEVP znj.Emona Muçi. Në datën 28.12.2023 është zhvilluar mbledhja e parë e Komisionit, me përbërje të ndryshuar, në të cilën, me propozim të Kryetares së Këshillit, është zgjedhur kryetare e Komisionit Znj.Emona Muçi.

Ky Komision është asistuar përgjatë vitit 2023, nga tre këshilltaret ligjore znj.Rezarta Taushani, znj.Aferdita Deda dhe znj. Dorina Prifti.

Gjatë vitit 2023, Komisioni ka organizuar punën me qëllim përmbushjen e funksioneve, duke zhvilluar veprimtarinë e tij në disa drejtime, si më poshtë:

- Hartimin, diskutimin dhe paraqitjen për miratim të akteve nënligjore normative që përfshijnë fushën e veprimtarisë së KVEVP, si dhe veprimtari të tjera, në bashkëpunim me Komisionet e tjera të përhershme dhe të përkohshme të Këshillit;
- Trajtimin e kërkesave të gjyqtarëve drejtuar Këshillit për çështje që janë në fushën e veprimtarisë së KVEVP dhe paraqitjen e tyre pranë Këshillit për vendimmarrje;
- Administrimin e kërkesave të gjyqtarëve për ushtrimin e veprimtarive jashtë funksionit dhe raportimin vjetor lidhur me këto veprimtari;
- Trajtimin e vazhdueshëm të dokumentacionit dhe praktikave të kaluara pranë Komisionit;
- Fillimin dhe zhvillimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për periudhat e vlerësimit 2013-2016, 2017-2019, 2020-2022 dhe vlerësimin e përshpejtuar të detyruar, në rastet e konkurrencës të gjyqtarëve për ngritje në detyrë.

II. RAPORTIM I VJEÇAR PËR SISTEMIN E VLERESIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARËVE

A. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E AKTEVE PLOTËSUESE TË SKEMËS SË VLERËSIMIT

Gjatë punës një vjeçare, Komisioni është angazhuar në procesin e hartimit, diskutimit dhe paraqitjes për miratim pranë Këshillit të akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë:

1. PROJEKT-AKTI PËR MIRATIMIN E “RREGULLAVE TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARËVE TË KOMANDUAR NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR”, I MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 159, DATË 05.04.2023 TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Ky akt ka për qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në përputhje me ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Për shkak të natyrës së punës që kryen gjyqtari i komanduar dhe pozicionit ku ai shërben, rregullat e vlerësimit të këtyre të fundit, janë hartuar në harmonizim me detyrimet që burojnë nga Ligji për Statusin, por edhe Ligji Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, për aq sa ky ligj mund të zbatohet për shkak të pozicionit të punës, pa cenuar asnjë garanci që lidhet me statusin e gjyqtarit. Këto rregulla respektojnë parimet e pavarësisë, meritokracisë dhe zhvillimit të karrierës, efikasitetit, procesit të rregullt ligjor dhe konfidencialitetit parashikuar në nenin 69 të Ligjit për Statusin.

Akti ka si pjesë të tij integrale tekstin kryesor ku parashikohen rregullat lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në KLGJ, si dhe 7 (shtatë) Lidhjet, pjesë përbërëse e tij:

Lidhja nr.1 - “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, shpjegon në mënyrë të detajuar mënyrën e përcaktimit të nivelit të vlerësimit të gjyqtarit të komanduar, për secilin kriter të vlerësimit të përcaktuar nga ligji;

Lidhja nr.2 - Formati standard “Raport përshkrues vjetor i punës së gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor” përmban një përmbledhje faktike të detyrave të kryera dhe aktivitetëve të tjera të gjyqtarit të komanduar gjatë vitit kalendarik paraardhës.

Lidhja nr.3- Formati standard *“Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative”* përmban mendimin dhe vlerësimin që struktura përgjegjëse organizative, monokratike apo kolegjiale, i bën veprimtarisë së gjyqtarit të komanduar, për shkak të mbikëqyrjes në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative të punës së gjyqtarit.

Lidhja nr.4- Formati standard *“Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative”* përmban mendimin dhe vlerësimin që struktura përgjegjëse administrative, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë Gjyqësor, i bën veprimtarisë së gjyqtarit të komanduar, për shkak të mbikëqyrjes në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë administrative të punës së gjyqtarit.

Lidhja nr.5- Formati standard *“Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”* plotësohet nga gjyqtari i komanduar në zbatim të nenit 86 të Ligjit për Statusin dhe nenit 15 pika 1 të rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshilli. Ky është vlerësimi i kryer nga gjyqtari i komanduar mbi aftësitë e tij etike dhe profesionale gjatë periudhës së vlerësimit, në të cilin përfshihen edhe komentet ose kundërshtimet në lidhje me mendimet vjetore periodike të strukturës përgjegjëse organizative dhe administrative.

Lidhja nr.6- Formati standard *“Projektraporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar”* hartohet bazuar në parashikimet e neneve 53, paragrafi 10, 68 e vijues, 89 e vijues dhe 93 të Ligjit për Statusin, për aq sa këto dispozita janë të zbatueshme, si dhe rregullat për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshilli e Lartë Gjyqësor. Me qëllim përcaktimin e shkallës së aftësisë së gjyqtarit të komanduar për çdo tregues, aspekt dhe kriter vlerësimi, relatori i procedurës së vlerësimit, bazuar në këtë format standard, bën analizë të integruar të të gjitha të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit.

Lidhja nr.7- Formati standard i tabelës së pikëzimit dhe shkallës së aftësisë së gjyqtarit të komanduar, ku pasqyrohen kriteret e vlerësimit, shkalla e aftësisë, pikëzimi dhe niveli i vlerësimit të gjyqtarit të komanduar.

B. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT LIDHUR ME PROCEDURAT E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARËVE TË FILLUARA GJATË VITIT 2023

Gjatë periudhës 1-vjeçare të raportimit lidhur me vlerësimet, Komisioni është angazhuar në:

- ❖ Kryerjen e gradimeve për periudhën 3 vjeçare të vlerësimit 2013-2016, për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar;
- ❖ Kryerjen e vlerësimeve të përshpejtuara të detyruara për vitin e fundit kalendarik për gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë;
- ❖ Kryerjen e vlerësimeve periodike, duke llogaritur fillimin e periudhës së vlerësimit mbi bazën e kohës së punës së kryer nga gjyqtarët në detyrë (periudha vlerësimi 2017-2019, 2020-2022) e ata të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- ❖ Përcaktimi i listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele.

B.I FILLIMI I PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIM) PËR PERIUDHËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, në zbatim të nenit 171, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 22.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, ka administruar dosjet me aktet e vlerësimit profesional për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, përcjellë nga organet e rivlerësimit pranë Këshillit, pasi vendimet respektive për secilin gjyqtar kanë marrë formë të prerë.

Gjatë vitit 2023, për të gjithë gjyqtarët për të cilët vendimi i organeve të rivlerësimit kalimtar ka marrë formë të prerë dhe janë përcjellë dosjet përkatëse pranë Këshillit, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimi) **për 39 (tridhjetë e nëntë) gjyqtarë**, si dhe janë përcaktuar me short relatori dhe nëpunësi përgjegjës për vlerësimin.

2. Me vendimin nr. 81, datë 16.02.2023 ka filluar procedura e vlerësimit për 20 (njëzet) gjyqtarë, konkretisht për gjyqtarët:
 - 2.1 Enkela Vlora, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - 2.2 Fatri Islamaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
 - 2.3 Albert Meça, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

- 2.4 Nurjeta Pogaçe, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
 - 2.5 Eglantina Mikani, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
 - 2.6 Anila Guri, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - 2.7 Irena Gjoka, gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
 - 2.8 Gerd Hoxha, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - 2.9 Ardit Mustafa, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - 2.10 Valdete Hoxha, gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
 - 2.11 Edvan Veçani, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - 2.12 Luljeta Kole, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
 - 2.13 Markelian Koça, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë *(aktualisht anëtar në Këshillit të Lartë Gjyqësor)*;
 - 2.14 Enerjeta Shehaj, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit;
 - 2.15 Vjola Canaj, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;
 - 2.16 Etleva Deda, gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
 - 2.17 Etleva Gjamo, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
 - 2.18 Olkeda Lice, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 - 2.19 Alfred Konomi, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 - 2.20 Sokol Pasho, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
3. Me vendimin nr. 523, datë 05.10.2023 ka filluar procedura e vlerësimit për 17 (shtatëmbëdhjetë) gjyqtarë, konkretisht për gjyqtarët:
- 3.1 Majlinda Dogga, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - 3.2 Entela Shedula, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
 - 3.3 Niko Rapi, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

- 3.4 Antonela Prendi, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - 3.5 Arta Llazari, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
 - 3.6 Selvie Gjoçaj, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
 - 3.7 Altin Shkurti, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - 3.8 Gentiana Muçaj, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (*aktualisht anëtare në Këshillit të Lartë Gjyqësor*);
 - 3.9 Miranda Andoni, gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
 - 3.10 Elona Toro, gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
 - 3.11 Fahrije Stringa, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - 3.12 Nafije Hasko, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (*aktualisht caktuar në skemë delegimi në Gjykatën Administrative të Apelit*);
 - 3.13 Dritan Caka, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - 3.14 Elvana Çiçolli, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (*aktualisht caktuar në skemë delegimi në Gjykatën Administrative të Apelit*);
 - 3.15 Engjëllushe Tahiri, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - 3.16 Alma Kodraliu, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - 3.17 Ejona Lazellari, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (*aktualisht transferuar për kohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*);
4. Me vendimi nr. 725, datë 07.12.2023 ka filluar procedura e vlerësimit për 2 (dy) gjyqtarë, konkretisht për gjyqtarët:
- 4.1 Anila Karanxha, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - 4.2 Adriatik Bocaj, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Po kështu, gjatë vitit 2023, Komisioni ka paraqitur në Këshill projektvendimet për mosfillimin e procedurave të vlerësimit të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016 **për 10 (dhjetë) gjyqtarë**, për shkak se procedura e vlerësimit nuk mund të fillonte, në kushtet kur

koha e ushtrimit të detyrës që përfshihet në periudhën e vlerësimit 2013-2016, e cila përbën periudhë të plotë vlerësimi në kuptim të neneve 84 dhe 171/5 të Ligjit për Statusin, është më e shkurtër se një vit, sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 4 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019, mbi bazën e të cilave janë miratuar vendimet si më poshtë:

5. Vendim nr.73, datë 13.02.2023 “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren Armela Hasantari”;
6. Vendim nr.76, datë 13.02.2023 “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtarin Artan Jahollari”;
7. Vendim nr.77, datë 13.02.2023 “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren Ina Hoxhaj”;
8. Vendim nr.154, datë 29.03.2023 “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren Oltjona Goxha”;
9. Vendim nr.210, datë 13.02.2023 “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtarin Paulin Çera”;
10. Vendim nr.319, datë 14.06.2023 “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren Esmerilda Habili”;
11. Vendim nr.370, datë 13.07.2023 “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren Ersida Bajgora”;
12. Vendim nr.501, datë 28.09.2023 “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren Matilda Fetau”;
13. Vendim nr.502, datë 28.09.2023 “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren Yrfet Shkreli”;
14. Vendim nr.701, datë 30.11.2023 “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtarin Kujtim Vraniçi”.

B.II FILLIMI I PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË PËRSHPEJTUAR TË DETYRUAR PËR VITIN E FUNDIT KALENDARIK

Gjatë vitit 2023, për të gjithë gjyqtarët të cilët kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, apo për gjyqtarët që kanë kandiduar në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e

Durrës, Këshilli ka filluar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar **për 12 (dymbëdhjetë) gjyqtarë**, si dhe janë përcaktuar me short relatori dhe nëpunësi përgjegjës për vlerësimin. Konkretisht:

15. Me vendimin 144, datë 28.03.2023, ka filluar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar, për vitin kalendarik 2022, për 4 (katër) gjyqtarët:

- 15.1 Artan Jahollari, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
- 15.2 Gentian Marku, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Pukë (*aktualisht transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*);
- 15.3 Nertila Kape, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (*aktualisht transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*);
- 15.4 Vladimir Skënderi, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

16. Me vendimin nr. 325, datë 14.06.2023 ka filluar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar, për vitin kalendarik 2022, për 6 (gjashtë) gjyqtarët:

- 16.1 Besmir Stroka, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
- 16.2 Gerd Hoxha, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- 16.3 Paulin Çera, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
- 16.4 Matilda Fetau, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
- 16.5 Oltjona Goxha, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- 16.6 Elvana Çiçolli, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (*aktualisht caktuar në skemë delegimi në Gjykatën Administrative të Apelit*);

17. Me vendimin nr.326, datë 14.06.2023, ka filluar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar, për vitin kalendarik 2019, për 2 (dy) gjyqtarë:

- 17.1 Ardit Mustafaj, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- 17.2 Niko Rapi, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, sipas Programit të Vlerësimeve të vitit 2023, të miratuar me vendimin nr. 561, datë 29.12.2022, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2020-2022, me vendimin si më poshtë:

18. Vendim nr. 173, datë 18.04.2023 “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2020-2022, për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2023”, nëpërmjet të cilit ka filluar procedura e vlerësimit **për 9 (nëntë) gjyqtarë**. Konkretisht, Këshilli ka filluar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2020-2022, si dhe janë përcaktuar me short relatori dhe nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, për gjyqtarët e mëposhtëm:

- 18.1 Ardit Kuka, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër *(aktualisht transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan)*;
- 18.2 Suela Dashi, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë *(aktualisht transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës)*;
- 18.3 Ervin Sulaj, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
- 18.4 Merita Karaj, gjyqtare në gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;
- 18.5 Olti Skrame, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë *(aktualisht transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës)*;
- 18.6 Amarilda Sulaj, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër *(aktualisht transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë)*;
- 18.7 Suela Xhani, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë *(aktualisht transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës)*;
- 18.8 Enkeleda Dalipi, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës *(aktualisht transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë)*;
- 18.9 Afërdita Caco, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë të Tiranë.

B.IV FILLIMI I PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL PËR GJYQTARËT E KOMANDUAR NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Bazuar në Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve pjesë e të cilit janë edhe rregullat për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor të miratuar me vendimin e KLGJ nr.159, datë 05.04.2023, kandidimit në procedurat për ngritje

në detyrë, si dhe parashikimeve të nenit 58 të Ligjit për Statusin, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për 4 (katër) gjyqtarë, gjatë kohës së komandimit në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Konkretisht:

19. Me vendimin nr.174, datë 25.04.2023, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj.Marsela Pepi, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-07.02.2020;
20. Me vendimin nr.175, datë 25.04.2023, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, znj. Zhaneta Pira, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-15.04.2021;
21. Me vendimin nr.176, datë 25.04.2023, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, z. Qemal Zaimi, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-01.06.2020;
22. Me vendimin nr.327, datë 14.06.2023, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, znj. Marinela Osmani, për periudhën e vlerësimit 10.02.2020-21.11.2022.

B.V MIRATIMI I LISTES SË GJYQTARËVE QË KANË OSE MUND TË KENË DY VLERESIME, NJË VLERESIM, SI DHE TË GJYQTARËVE QË NUK KANË E NUK MUND TË KENË ASNJË VLERËSIM, PËR EFEKT TË KANDIDIMIT NË PROCEDURAT E LËVIZJEVE PARALELE

Në zbatim të nenit 43 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, faza e parë e procedurës së lëvizjes paralele, për çdo pozicion të lirë të shpallur, fillon për gjyqtarët kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike profesionale. Në rast se për pozicion konkret nuk ka kandidatë të tillë, ata janë tërhequr nga kandidimi ose janë skualifikuar për mosplotësim kushtesh, procedura e lëvizjes paralele vazhdon për kandidatët që kanë ose mund të kenë një vlerësim, e në mungesë edhe të këtyre të fundit, vijon me kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim. Për të bërë të mundur në veçanti gjyqtarët që “mund të kenë 2 vlerësime, 1 vlerësim, ose nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, në pikën 9 të çdo vendimi hapje procedure lëvizje paralele, Këshilli ka parashikuar se: *“Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli miraton me vendim listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, të atyre që kanë ose mund të kenë një vlerësim, si dhe të kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”*.

Bazuar sa më sipër, gjatë vitit 2023, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, pasi verifikoi përvojën profesionale të secilit nga gjyqtarët kandidatë dhe ecurinë e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për secilin prej tyre, sipas Skemës së Re të Vlerësimit të Gjyqtarëve, vlerësime të mbaruara, atyre në proces të filluara ose që mund të fillonin sipas programit të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli, si dhe bazuar në detyrimin e parashikuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.263, datë 21.11.2019 “Për

miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” për fillimin e procedurës së vlerësimit të përsheptuar të detyruar për gjyqtarët që kanë aplikuar për lëvizje paralele, ka paraqitur në Këshill projekt-aktet përkatëse, të cilat janë miratuar me vendimet si më poshtë:

23. Vendimi nr.77, datë 13.02.2023 “Për miratimin e për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023”;
